



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

Prill 2023

NJOFTIM

Në kuadër të projektit Erasmus + midis **Instituto Politecnico de Viana do Castelo** dhe **Universitetit Bujqësor të Tiranës**, shpallet thirrja për aplikime për shkëmbim studentësh për Semestrin e parë 2023-2024, në Viana do Castelo, Portugali.

Në këtë projekt mund të aplikojnë studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjekësisë Veterinare.

Para aplikimit studentët duhet të kërkojnë në faqen zyrtare të Universitet pritës dhe të përzgjedhin modulet që do të zhvillojnë, të cilat duhet të përkojnë me modulet që do të ndiqnin këtu në semestrin përkatës. Informacion mbi modulet mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:
<https://www.ipvc.pt/en/estudar/estudar-no-ipvc/cursos/licenciaturas/>.

Nga ana e Universitetit Bujqësor, si partner i projektit, bëhet një renditje paraprake e studentëve aplikues. Kjo renditje u dërgohet partnerëve. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Vërtetim nga Sekretaria Mësimore
- Lista e notave
- CV
- Letër motivimi

Afati i fundit për aplikim është: **20 Prill 2023**

Dokumentacioni i kërkuar do të dërgohet nëpërmjet email-it në adresën:
erasmusoffice@ubt.edu.al